



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

Syllabusi i lëndës: Metodat dhe teknikat cilësore në kërkimet shkencore

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Metodat cilësore në kërkim shkencor
Niveli:	Master
Status i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I (sem. I)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Krijimi i nje vizioni te integruar per metodat kërkimore cilësore dhe komponentet e tyre, analizimi dhe kuptimi i lidhjeve midis metodave dhe teknikave kërkimore në biznes, analiza e të dhënave, nxjerrja e përfundimeve shkencore, ngritja dhe perdorja e teorive per spjegimin dhe parashikimin e sjelljes së trendeve financiare në firmën e biznesit apo në institucionin financiar, dhe reagimi i grupeve të interesit. Këto jane metodat, teknikat dhe njohuritë me të cilat zgjerohet dija e drejtuesve të ardhshëm të biznesit dhe institucioneve financiare, të cilët ndjekin këtë disiplinë.
Qëllimet e lëndës:	• Të përshkruajë dhe shpjegojë çfarë janë kërkimet në biznes dhe se si ato ndryshojnë nga sistemi i mbështetjes së vendimeve të biznesit dhe sistemet e inteligjencës në biznes. • Të shpjegojë trendet që ndikojnë kërkimet në biznes dhe hierarkia në zhvillimin e vendim-marrjes në biznes. • Të shpjegojë dallimin ndërmjet kërkimit të mirë në biznes dhe kërkimeve që cilësohen me mungesë të cilësisë profesionale. • Të kuptojë, përshkruajë, dhe shpjegojë natyrën e procesit kërkimor. • Të hartojë projekte kërkimore dhe zhvillojë ide mbi përfitimet për organizatën. • Të përshpejtojë qarkullimin e informacionit në organizatë dhe të kultivoj format e përshtatshme të komunikimit të të gjeturave nga kërkimet në biznes. • Të hartojë, komentojë dhe analizojë raportet nga kërkimet e zbatuara dhe të implementojë ato; • Të dëshmojë aftësi profesionale dhe përgatitje akademike në mënyrë që të sigurojë mbijetesë në tregun e ashpër të

	punës;
Rezultatet e pritura të nxënies:	Njohuri (NJ): *NJ1. Kupton dhe shpjegon procesin kërkimor në biznes, duke dalluar kërkimet shkencore nga mbështetja e vendim-marrjes dhe sistemet e inteligjencës në biznes. *NJ2. Analizon dhe shpjegon trendet dhe faktorët që ndikojnë në kërkimet e biznesit, dhe vlerëson hierarkinë dhe ndikimin e këtyre trendeve në zhvillimin e vendimmarrjes në biznes. *NJ3. Ndërton dallimin midis kërkimeve shkencore me cilësi të lartë dhe kërkimeve të dobëta, duke përshkruar standardet e kërkimit të mirë në biznes. Aplikim-Kompetenca (A-K): **A-C1. Aplikon metodat cilësore për të realizuar kërkime të avancuara në fushën e menaxhimit të biznesit, duke zhvilluar projekte kërkimore të bazuara në analiza të thelluara. **A-C2. Harton dhe implementon projekte kërkimore, duke përdorur metoda cilësore për të adresuar probleme dhe mundësi strategjike për organizatën. **A-C3. Përgatit dhe analizon raporte kërkimore dhe ofron rekomandime të bazuara në gjetjet e kërkimit që kontribuojnë në përmirësimin e praktikave të biznesit dhe vendimmarrjes. **A-C4. Zhvillon aftësi të avancuara për të komunikuar gjetjet kërkimore në forma të përshtatshme për audienca të ndryshme, përfshirë prezantime dhe raporte profesionale. Aftësi (A): ***A1. Demonstron aftësi profesionale dhe përgatitje akademike për të realizuar kërkime të besueshme dhe të dobishme për organizatat, duke siguruar që rezultatet të kontribuojnë në zhvillimin e vazhdueshëm të industrisë. ***A2. Aftësi për të bashkëpunuar efektivisht në grupe kërkimore dhe për të menaxhuar projekte kërkimore, duke shfaqur udhëheqje dhe menaxhim të avancuar të burimeve dhe kohës. ***A3. Përdor aftësitë analitike dhe kritike për të zhvilluar dhe vlerësuar projektet kërkimore, duke i përshtatur ato për zhvillime të reja në fushat e menaxhimit dhe financës. <i>Sqarim:</i> Rezultatet e pritura të syllabusit janë të përpiluara konform rezultateve të pritura të programit, në përputhje me standardet e AKA-së.

	*Njohuri (Nj) **Aplikim-Kompetenca (A-K) **Aftësi (A)		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume,seminare	1	5	5
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgaditja përfundimtare për provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	5	5
Projektet,prezentimet ,etj	1	5	5
Totali			150
Sqarim: 1 orë = 25 ECTS kredi.			
Përshtatja e ECTS me orët totale: 150 orë ÷ 25 = 6 ECTS kredi.			
Metodologjia e mësimdhënies:	• Prezantimi i temës mësimore në Power Point • Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime • Rast studimi apo detyrë (për orën e ushtrimeve) lidhur me temën e ligjëruar		
Metodat e vlerësimit:	• Punimi seminarik dhe prezentimi: 0-50% • Provimi përfundimtar 0- 50%		
Literatura			
Literatura bazë:	▪ Matthews Bob & Ross.Liz. 2010. Metodat e hulumtimit		

	– Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane. Tiranë: CDE
Literatura shtesë:	▪ Cooper, Donald R. & Pamela S. Schindler, 2011: <i>Business Research Methods</i>, 11 edition, McGraw-Hill/Irwin. ▪ Saunders, Mark, 2009: <i>Research methods for business students</i>, Pearson Education Limited
Plani i dizejnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në hulumtimin cilësor
Java e dytë:	Llojet, procesi dhe etika në hulumtimin cilësor
Java e tretë:	Intervista si metodë në hulumtimet cilësore
Java e katërt:	Observimi si metodë në hulumtimet cilësore
Java e pestë:	Studim rasti si metodë në hulumtimet cilësore
Java e gjashtë:	Fokus grupi /Grupi i përqendruar/ si metodë në hulumtimet cilësore
Java e shtatë:	Analiza dhe interpretimi i të dhënave cilësore
Java e tetë:	Të shkruarit e hulumtimit cilësor
Java e nëntë:	Praktikat dhe procedurat e mira shkencore dhe gabimet në shkencë
Java e dhjetë	Struktura e punimit hulumtues
Java e njëmbëdhjetë:	Kërkimi/shfrytëzimi i burimeve dhe përdorimi i bibliografisë
Java e dymbëdhjetë :	Prezantimi i projekteve hulumtuese
Java e trembëdhjetë:	Prezantimi i projekteve hulumtuese - vazhdim
Java e katërmbëdhjetë:	Prezantimi i projekteve hulumtuese - vazhdim
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezantimi i projekteve hulumtuese - vazhdim

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së.

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale.
- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.